



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PËRMBARIMIT
ZYRA PËRMBARIMORE LUSHNJE

Nr. 441 Regj

Lushnje, më 17.09.2021

VENDIM SHPALLJE

(Lidhur me ekzekutimin e "Urdhërit të Ekzekutimit" të titullit ekzekutiv të debitorit)

Unë Endrin Kashari, me detyrë Kryetar i Zyrës së Përmbarimit Lushnje, pasi studiova aktet procedurale të çështjes përmbarimore nr.441, datë 28.07.2021 bazuar në vendimin nr. 473, datë 21.06.2019 të Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnje,

KONSTATOVA:

Se në datë 28. 07. 2021 është depozituar pranë Zyrës së Përmbarimit Lushnje kërkesa e kreditorit Erion Petraq Janji së bashku me vendimin nr. 473, datë 04.12.2015 të Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnje për vendimin cicil nr. 902, datë 21. 04. 2019 të Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnje, me palë:

- Kreditor: Erion Petraq Janji
- Debitor: Mirgeta Todi Prifti
- Objekti: Pension ushqimor

Nga ana e Zyrës së Përmbarimit Lushnje ka filluar procedura në bazë të nenit 515 e vijues të K.Pr. Civile dhe ligjit nr. 8730, datë 18.01.2001 " *Për Organizimin dhe Funkcionimin e Shërbimit Përmbirimor Gjyqësor*", i ndryshuar për ekzekutimin e detyrueshëm të titullit ekzekutiv të sipërcituar. Nga verifikimi i kryer nga ana jonë në bashkëpunim me organet kompetente rezulton se debitorja Mirgeta Todi Prifti nuk ka marr dijeni nëpërmjet shërbimit postar, si rezultat i kësaj, bazuar në nenet 133/a, 133/b, 144/a dhe nenit 517 të Kodit të Proçedurës Civile duhet të bëhet njoftimi me shpallje publike i debitorës lidhur me detyrimin që ka ajo ndaj palës kreditore Erion Petraq Janji për detyrim ushqimor për fëmijët e saj Renato Janji dhe Emanuel Janji në vlerën 56 000 lekë dhe çdo muaj nga 7 000 lekë.

Sa më sipër në mbështetje të nenit 133/a, 133/b, 144/a dhe 517 të Kodit të Proçedurës Civile dhe ligjit nr. 8730, datë 18.01.2001 " *Për Organizimin dhe Funkcionimin e Shërbimit Përmbirimor Gjyqësor*", i ndryshuar,

VENDOSA:

1. Të kryej njoftimin nëpërmjet shpalljes publike me afat 20 (njëzet) ditor (duke marr parasysh edhe komunimin postar), nga data 20.09.2021 – 10.10.2021 të debitorës Mirgeta Todi Prifti;
2. Ky vendim përpilohet në 5 kopje, ku një kopje afishohet në vëndbanimin e fundit të palës debitore , një kopje afishohet në këndin e njoftimit të Zyrës së Përmbarrimit Lushnje, një kopje dërgohet për afishim në këndin e publikimeve të Bashkisë Divjakë, një kopje dërgohet për afishim në ambientet e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje dhe një kopje dërgohet për publikim në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarrimit Tiranë.
3. Kjo shpallje publike ka vlerën e aktit të njoftimit për palën debitore Mirgeta Todi Prifti me banim në Nd. 212, Bashkia Divjakë;
4. Pala debitore Mirgeta Todi Prifti me banim në Nd. 212, Bashkia Divjakë të paraqitet pranë Zyrës së Përmbarrimit Lushnje në lagjen “Çlirimi”, kati i parë, hyrja tek sekretaria e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje dhe të marr kontakthe me përmbarruesin gjyqësor të çështjes përmbarrimore për t’iu vënë në dispozicion aktet e dosjes përmbarrimore, pasi me kalimin e këtij afati do të vijohet me ekzekutim e detyruar sipas nenit 519 e ne vijim të Kodit të Proçedurës Civile.

U shpall në Lushnje, sot më datë 17.09.2021

KRYETARI I ZYRËS
Endrin Kashari

